

19.02.2021
Ora 17:45

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, të Komisionit Rregullator”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, A.Llano
- Parti Politike: PD (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj)

Znj.I.Nano: Nisim mbledhjen e Komisionit Rregullator të pranishëm janë të pestë anëtarët e Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zoti Celibashi, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës gjithashtu. Janë të pranishëm dhe përfaqësues të disa partive politike të akredituara në KQZ. Mbledhja e sotme ka vetëm një pikë në rendin e ditës. Kemi për te shqyrtuar projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr.11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, të Komisionit Rregullator”.

Znj.H.Vukaj: Zonja Nano nuk po dëgjoheni... në fakt kam një kërkesë të vogël, nuk di më dëgjoni?! Shpresoj të më dëgjojnë kolegët. Kam një kërkesë jashtë rendit të ditës. Diçka që më nxiti në kuadër të lançimit mediatic, të këtyre dy ditëve dhe meqenëse përbën shqetësim për situatën në të cilën ndodhemi. Bëhet fjalë për numrin prej 1 milion e 68 mijë shtetas shqiptarë të cilët nuk kanë ende sigurinë, nëse do të votojnë apo jo. Në këtë kuadër do të lutesha i nderuar zoti Komisioner *(nuk dëgjohet)* i një prej organeve që përfaqëson lidhjen me institucionet e tjera, do t’u lutesha t’i përcillnit një kërkesë DPGJC për të na informuar se çfarë ka bërë deri më tani në lidhje me sigurinë për kthimin e kësaj *(nuk dëgjohet)* për këta shtetas? Është një shifër alarmante e cila në çdo moment mund të kthehet si kontigjent i përdorur nga të interesuar dhe të tretë të cilët kanë dëshmuar si eksperiencë të ndërhyrjes në procesin zgjedhor. Këtë e kemi si nga përvoja, si nga përvojat mediatike. Dimë shumë mirë që blihen kartat, dihet mundësia ekonomike e tyre për të pasur një kartë ose për t’ia marrë kartën. Kështu që për të hequr çdo mundësi të përdorimit të kësaj kategorie, të shtetasve shqiptarë të cilëve ju skadon dokumenti i identifikimit në datën e zgjedhjeve. Atëherë më lind nevoja për të pasur këtë informacion. Ashtu sikurse unë kam dakordësinë edhe të zotit Çakaj, por besoj dhe të kolegëve të tjerë, të cilët pa dyshim do të donin të dinin realisht gjendjen dhe iniciativën e DPGJC në lidhje me këtë çështje. Një pikë tjetër meqenëse patëm në dëgjuesë Drejtorin e DPGJC para disa kohësh, i cili shpalosi projektin e realizuar nga ku dolën dhe problemet e zhvendosjes së vendbanimeve të qindra e mijra shetasve shqiptarë pa kërkesën e tyre. Atëherë kërkuam që të kishim një kopje të këtij projekti, por besoj që ka ardhur momenti që ta kemi shkresërisht këtë kërkesë dhe njëkohësisht përgjigjen po shkresërisht nga DPGJC. Faleminderit, ndjesë dhe njëherë për

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

ndërhyrjen, pasi vërtet jemi në rrethana dhe kushte jo optimale të zhvillimit të një mbledhjeje, faleminderit!

.....

Znj.H.Vukaj: Nuk e di në u dëgjova apo jo, u përcollën siç duhet kërkesat, se po më thonë që nuk isha dëgjuar siç duhet, apo me shkëputje? Ju lutem kolegë nuk di u dëgjova apo jo, ju lutem një konfirmim?

Paneli i Rregullatorit: – U dëgjuat!

Znj.H.Vukaj: Dakord, ju faleminderit!

Z.I.Celibashi: Zonja Kryetare, mund të vazhdojmë?

Znj.I.Nano: Po zoti Celibashi, mund të vazhdoni!

Z.I.Celibashi: Dakord, para se të filloj me relatimin e çështjes që është në rendin e ditës, ju bëj me dije për sa zonja Vukaj parashtrroi, një informacion. Para disa ditëve kam pas një kontakt me Ministrin për këtë çështje, besoj se mund ta adresojmë dhe zyrtarisht kërkesën për informacion nga DPGJC mbi situatën e dokumenteve të identifikimit të cilëve u ka kaluar afati i përdorimit, pra, vlefshmëria si dokument. Duke qenë se është një çështje vërtet shumë e rëndësishme, mendoj se duke parë dhe ecurinë e rinovimit të dokumenteve të identifikimit deri tani është një numër fare i papërfillshëm dhe mund ta dërgojmë edhe zyrtarisht kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë të dokumenteve të identifikimit. Kjo është një çështje që në ditët në vijim mbetet ta konsultojmë bashkërisht, por dhe me përfaqësues të partive politike. Ndërkohë po i adresoj zyrtarisht Drejtorit të DPGJC dhe kërkesën për të marrë kopje të projektit që ka zhvilluar DPGJC në lidhje me saktësimin e adresave të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

qytetarëve. Tani për të kaluar tek projektakti që kemi paraqitur për shqyrtim, në fakt ajo çfarë ne kemi propozuar nuk synon aspak që të çënojë të gjitha ato standarte që lidhen me garancinë dhe sigurinë e administrimit të procesit zgjedhor. Por, duke marrë në konsideratë faktin që, që nga momenti që ka hyrë në fuqi ky rregulli i pasjes së vulave rezervë për çdo qendër votimi është dashur jo më shumë se 5-6 herë që të bëhej zëvendësimi i këtyre vulave, pra i vulave të qendrave të votimit, me vulat rezervë dhe duke konsideruar faktin që prodhimi i vulave rezervë ka një kosto relativisht të lartë. Në kuadër të një miradministrimi të buxhetit për qëllime zgjedhore dhe me idenë që paratë që mund të kursehen nga reduktimi i numrit të vulave rezervë që do të prodhohen të përdoren për qëllime të tjera të procesit zgjedhor. Kemi menduar që pa çënuar aspak të gjitha standartet që kemi për sigurinë e procesit zgjedhor propozojmë që numri i vulave rezervë për çdo qendër votimi të mos jetë sa është numri i qendrave të votimit, por të jetë një numër shumë më i reduktuar. Ndërkohë të respektohen të gjitha protokollet që duhen për të bërë zëvendësimin e vulës së qendrës së votimit kur është rasti. Në tërësi kosto e prodhimit të vulave rezervë shkonte 9.7 milion lekë, nëse ne do të prodhojmë jo më shumë se 1000 vula rezervë, kursejmë një sasi parash rreth 8.5-8.6 milion lekë, para të cilat KQZ mund t'i përdorë për aspekte të tjera të procesit zgjedhor. Nga ana tjetër, sikurse e thashë, gjithë rregullat e tjera të cilat lidhen me administrimin e vulave rezervë dhe protokollin e zëvendësimit të vulës mbeten të pandryshuara. Nuk di u dëgjova qartë tek relatimi?

Paneli i Rregullatorit: Po po, relatimi ishte i qartë.

Z.I.Celibashi: Faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

Z.M.Çakaj: Me sa duket ka probleme teknike. Nëse kolegët bien dakord, e shtyjme me 5 minuta, ose disa minuta vazhdimin e mbledhjes?

Z.D.Çaka: Unë jam dakord për 5 minuta.

Z.I.Celibashi: Mendoj të mos dalim, ndërkohë presim sa të bëhet e mundur pjesëmarrja e Kryetares.

(Ndërprerje e seancës për të pritur dhe pjesëmarrjen e zonjës Ilirjana Nano)

Rifillon mbledhja e Komisionit Rregullator

Ora 18:17

Znj.I.Nano: Nuk di nëse dëgjohem, me sa duket ka një problem teknik.

Paneli i Rregullatorit: Po dëgjoheni shumë mirë!

Znj.I.Nano: A mundet për shkak të problemeve teknike, një nga ju të marrë përsipër drejtimin e mbledhjes, ju lutem kolegë?

Paneli i Rregullatorit: Po!

Znj.I.Nano: Për të kaluar tek diskutimi në parim dhe pastaj për dy pikat e projektaktit?

Paneli i Rregullatorit: Po!

Znj.I.Nano: Paraprakisht po jap miratimin tim. Në çdo rast nëse do të ketë ndonjë ndërprerje është miratimi im në parim dhe për dy pikat e projektaktit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



Z.A.Çela: Nuk është futur akoma zonja Helga!

(Ndërprerje e seancës për të pritur dhe pjesëmarrjen e zonjës Helga Vukaj)

Rifillon mbledhja e Komisionit Rregullator

Ora 18:23

Z.M.Çakaj: Viojmë me aktin ndërkohë që stabilizohet edhe lidhja e zonjës Nano?

Paneli i Rregullatorit: Po!

Z.M.Çakaj: Referuar Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”, në cilësinë e anëtarit më të vjetër të Komisionit Rregullator, sigurisht më dakordësinë tuaj dhe sapo të stabilizohet dhe lidhja e Kryetares.

Z.D.Çaka: Zoti Çakaj, mendoj të vazhdoni se lidhja me Kryetaren është, kështu që mund të votohet me... zoti Çakaj, mikrofonin ju lutem!

Z.M.Çakaj: Atëherë, projektakti i sotëm i prezantuar dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka të bëjë me disa shtesa dhe ndryshime të Vendimit nr.11 datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”. Fillimisht referuar dhe rregullores do të vijojmë me miratimin në parim të projektaktit.

Kush është dakord në parim me projektaktin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

Me 5 vota pro miratohet në parim projektakti i paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve “Për disa ndryshime në vendimin nr.11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit” të Komisionit Rregullator”.

Referuar dhe “Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit Rregullator”, nëse përfaqësuesit e partive politike kanë propozime, shtesa, vërejtje, apo sugjerime janë të lutur të marrin fjalën tani dhe t’i bëjnë ato konkretisht. Në monitor shoh vetëm zotin Kaziaj.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Çakaj, nuk kemi ndonjë shtesë, apo propozim për të bërë, faleminderit!

Z.M.Çakaj: Dakord, ju falenderoj! Viojmë miratimin nen për nen.

Në pikën 1 të projektaktit parashikohet: Në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të KQV-së”, bëhen këto ndryshime:

1.Paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

1.1“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:

- a) numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi;
- b) formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë.”

Kush është dakord me këtë propozim?


Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

1.2 Paragrafi 8 ndryshohet si më poshtë vijon: “Në rast se njoftimi sipas paragrafit 4, të këtij vendimi, bëhet për vulën e Komisionit të Qendrës së

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

Votimit dhe për vulën e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit të së njëjtës qendër votimi, atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

a) pas administrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të njoftimit/kërkesës të Sekretarit të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, merr vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe të vulës së Kryetarit të Qendrës së Votimit përkatëse dhe zëvendësimin e tyre me vula rezervë;

b) Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas shkronjës “a”, të këtij paragrafi përcakton numrin e qendrës së votimit, tekstin e secilës vulë që nxirret nga përdorimi, dhe tekstin e secilës vulë rezervë që zëvendëson vulat e nxjerra nga përdorimi”.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Zoti Kaziaj, jeni të lutur në se keni në miratimin pikë për pikë të këtij projektakti, të këtyre ndryshimeve mund të ndërhyjni në çdo çast. Për shkak edhe të situatës jo të mundshme teknike, por në këto kushte jemi!

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit!

Z.M.Çakaj: Pika 2 e projektaktit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.


Këto janë standarte,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.02.2021*

Me 5 vota pro miratohet!

Dhe pika e fundit e këtij projektakti, standarte dhe kjo,

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Besoj se të gjithë jemi dakord kolegë me këtë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Si përfundim e miratojmë në tërësi projektaktin, pasi kemi miratuar këto ndryshime.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektaktit?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me vota pro miratohet!

Kolegë të nderuar, na falni për këto probleme teknike të ndodhura, shpresoj që në mbledhjen e ardhshme nëse kushtet do të na lejojnë ta zhvillojmë në kushte më të mira teknike, ose live në qoftë se do të ishte e mundur, ju faleminderit, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, natën e mirë!

Vendimi nr.5

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*